



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 27/1 dt.14.02.1996

MBI MIRATIMIN E STRUKTURES SE NDERMARRJES KOMUNALE
BANESA, KESHILLIT DREJTUES, AKTIVITETIN DHE FONDET PER
KETE NDERMARRJE

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.82/1, dt.28.06.1995, pasi u lexua relacioni i paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe nga N.K.Banesa, si dhe në bazë të Ligjit Nr.7672, dt.10.06.1992 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Lokal” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij dt.14.02.1996

VENDOSI

1. Të miratojë strukturën organizative të **Ndërmarrjes Komunale Banesa** si më poshtë :

1.ADMINISTRATA

1.Drejtor	1
2.Jurist	1
3.Dega Teknike	3
4.Dega e Financës	2
5.Dega e Furnizimit	1

6.Përgjegjësi i Administratës	1
7.Përgjegjësa Sektori	11
	(Sa Njësi Administrative ka qyteti).
8.Magaznier	2
9.Ekonomista	3

Gjithsej 25 vetë

2.PUNTORET BUXHETOR

1.Puntorë	22
2.Urgjensa	8
3.Roje	6
4.Shofera	5
5.Punëtorë transporti	3

Gjithsej 44 vetë

3.PUNTORE JO BUXHETOR

Gjithsej 55 vetë

2. Të miratojë Këshillin Drejtues të Ndërmarrjes si më poshtë :

1.Fatmir Maci Kryetar i K.Drejtues

2.Adelina Goga **Antare(Inxhinjere)**

3.Viktor Papa **Antare(Ekonomist)**

4.Filloreta Hajnaj **Antare(Inxhinjere)**

5.Vjollca Sanxhaku **Antare(Inxhinjere)**

Paga mesatare e Ndërmarrjes do të jetë **3.835 lekë** në muaj.

Paga minimale do të jetë **2.400 lekë** në muaj.

Mbështetur në Vendimin e K.Ministrave Nr.345, dt.10.08.1992 ku thuhet se paga e Drejtorit të Ndërmarrjes duhet të caktohet në kufitë 1-4 herë më i madh se paga minimale :

Atëherë paga e Drejtorit caktohet **9.250 lekë** në muaj(ku koefiçienti i rritjes së pagës është 2,5 herë).

Paga e antarëve të tjerë të Këshillit Drejtues përcaktohet sipas Udhëzimit të Ministrisë të Ndërtimit me Nr. Prot.965, dt.07.04.1994.

Për aktivitetin e Ndërmarrjes konform strukturës organizative të saj nevojiten gjithsej fonde buxhetore **30.500.000 lekë**(duke filluar nga muaji Mars 1996) prej të cilave **6.900.000** fond pagash plus Sigurime Shoqërore dhe diferenca në zëra të tjera.

3. Të miratojë aktivitetin e mirëmbajtjes për vend strehimet kur Këshilli i Ministrave të bëjë çeljen e fondeve përkatëse për këtë qëllim.
4. Të miratojë aktivitetin e mirëmbajtjes së fasadave të rrugëve kryesore.(riparim fasadash, lysterje)etj. Në bazë të fondeve që do të dalin për këtë qëllim nga studimi urbanistik përkatës.
5. N.K.Banesa të evidentojë të gjitha objektet Shtetërore në të cilat ushtrojnë aktivitetet e tyre partitë politike, shoqatat,

institucionet e tjera, dhe në zbatim të ligjeve në fuqi të marri qeratë e këtyre objekteve.

6. Për të gjitha banesat e paprivatizuara të zbatojë dispozitat ligjore për marrjen e qerave të tyre.
7. Të miratojë aktivitetin për çbllokimin e WC të kateve përdhe të banesave, të propozuara nga Ndërmarrja.
8. Miraton aktivitetin e shërbimit të urgjencës në banesa si çbllokime, lavamani, WC, plasje uji, e tjera.
9. Të miratojë propozimin e N.K.Banesa për ngritjen e një komisioni për evidentimin e materialeve jashtë përdorimit. Kjo listë pasi të plotësohet nga komisioni përkatës të paraqitet Këshillit Bashkiak për miratim.
10. Të miratojë të gjitha objektet e punës që ka paraqitur Ndërmarrja në relacionin e saj, për ushtrimin e aktivitetit sipas njësive administrative përkatëse. Këto ambiente të cilat bëjnë pjesë në mjetet themelore të kësaj Ndërmarrje janë :

1.Godina e administratës së Ndërmarrjes që ndodhet në rrugën “Gjon Muzaka”.

2.Njësia Nr.1 në godinën në rrugën “M.Grameno” pranë shkollës së Baletit.

3.Njësia Nr.2 dhe 3 në një zyrë dhe ambientet e magazinës në rrugën “V.Huta” pranë ambulancës së ish lagjes Nr.2.

4.Njësia Nr.4 në rrugën “A.Mojsiu” prapa Ndërmarrjes Artistike “Migjeni”.

5.Njësia Nr.5 në bodrumet Pallatet “Agimi” shkalla Nr.8, 12, 26. Në bodrumet te pallatet Aviacioni i vjetër shkalla Nr.9/4 dhe në rrugën “I.Qemali” Nr.34.

6.Njësia Nr.6 në magazinat dhe grupet e punës në ish “Kombinatin e Tekstileve”.

7.Njësia Nr.7 në bodrumet e grupit të punës në rrugën “Kavajës” Nr.136, grupi të punës në rrugën “M.Gjollesha” Nr.73 dhe grupit të punës në rrugën “Kongresi i Lushnjes” Nr.26.

8.Njësia Nr.8 grupi i punës në rrugën “D.Hekali” prapa shkollës së “Kuçe” nga ky objekt është hequr sipërfaqja prej 120 m² e cila me vendim të Bordit të Privatizimit është shitur.

9.Njësia Nr.9 në grupin e punës në rrugën “Maliq Muco” (dy zyra dhe gropat e gëlqeres).

10.Njësia Nr.10 në grupin e punës rruga “I.Alla”.

11.Njësia Nr.11 në “Laprakë” (tre gropat e gëlqeres dhe marangozi).

12.Magazinat e Ndërmarrjes në rrugën “Bab Rexha” (Kroi i Shëngjinit). Në kapital të kësaj Ndërmarrje të hyjnë si mjete themelore të gjitha ato objekte që kanë qënë mjete themelore të ish N.K.Banesave Nr.1, 2, 3 sipas inventarit kontabël të tyre, si dhe mjetet e xhiros.

11.Kjo Ndërmarrje të jetë me aktivitet pjesërisht buxhetor dhe në nvertësi të Bashkisë të Tiranës.

12.Financimi i saj të bëhet 30% nga të ardhurat e Bashkisë dhe 70% nga Buxheti i Shtetit.

13.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet :

1.Drejtoria e Administrimit Financiar

2.Drejtoria e Shërbimeve Publike

14.Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA